




Legal Alert Albania

January 2025



Albania's New Personal Data Protection Law: A Leap Towards GDPR Alignment

On December 19, 2024, the Albanian Parliament approved the new draft law "On Personal Data Protection," aligning its framework with the European Union's General Data Protection Regulation (GDPR). This marks a significant leap towards enhancing individual privacy rights and meeting European data protection standards.

Key Components of the New Law:

Alignment with GDPR: The new law introduces terms such as "data minimization", "pseudonymization", and "profiling", harmonizing with GDPR definitions including "genetic data" and "biometric data."

Scope and Applicability:

- Extraterritoriality:** The law applies to foreign controllers processing data of individuals in Albania. Such entities must appoint local representatives to ensure compliance.
- Entities:** It specifically affects sectors like banking, telecommunications, e-commerce, and insurance.

Data Protection Principles:

- Lawfulness & Transparency:** Data must be processed for lawful purposes.
- Data Minimization & Secure Storage:** Processing should be limited to necessary data, with stringent security measures.
- Retention Limits:** Data retention must not exceed necessity.

Rights of Data Subjects:

- Information & Access:** Refined rights ensure concise and transparent information is available.
- Right to be Forgotten & Data Portability:** Individuals can request data deletion and transfer between controllers.
- Objection to Processing:** Enhanced rights to restrict processing and file complaints.

Obligations for Controllers and Processors:

- Data Protection by Design/Default:** Ensuring data protection throughout operational stages.
- Documentation & Impact Assessment:** Controllers must maintain records and conduct DPIAs for high-risk processes.
- Breach Notification:** Controllers must notify authorities of data breaches within 72 hours.
- International Data Transfers:** The transfer of personal data to foreign countries or international organizations is permitted when the recipient is located in a country, territory, or belongs to one or more specific sectors within the foreign country or an international organization that provides an adequate level of data protection.

Ligji i Ri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Shqipëri: Një Hap Përpara në Përputhje me GDPR

Më 19 dhjetor 2024, Parlamenti i Shqipërisë miratoi projektligjin e ri "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", duke e përafuar kuadrin e tij me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave të Bashkimit Evropian (GDPR). Ky është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të të drejtave të privatësisë së individëve dhe përmbushjes së standardeve europiane për mbrojtjen e të dhënave.

Komponentet Kryesore të Ligjit të Ri:

Përputhja me GDPR: Ligji i ri prezanton terma të tillë si "minimizimi i të dhënave", "pseudonimizimi" dhe "profilizimi", duke u harmonizuar me përkufizimet e GDPR, duke përfshirë "të dhënat gjenetike" dhe "të dhënat biometrike".

Fusha dhe Zbatimi:

- Ekstraterritorialiteti:** Ligji zbatohet dhe për kontrollorët e huaj që përpunojnë të dhëna të individëve në Shqipëri. Këto subjekte duhet të caktojnë përfaqësues lokalë për të siguruar përputhjen.
- Subjektet:** Ndikon veçanërisht në sektorë si bankat, telekomunikacioni, tregtia elektronike dhe sigurimet.

Parimet për Mbrojtjen e të Dhënave:

- Ligjshmëria & Transparenca:** Të dhënat duhet të përpunohen për qëllime të ligjshme.
- Minimizimi i të Dhënave & Ruajtja e Sigurt:** Përpunimi duhet të kufizohet në të dhënat e nevojshme, me masa të rrepta sigurie.
- Afatet e Ruajtjes:** Ruajtja e të dhënave nuk duhet të zgjasë më shumë se sa është e nevojshme.

Të Drejtat e Subjekteve të të Dhënave:

- Informimi & Akses:** Të drejtat e rafinuara sigurojnë informacion të saktë dhe transparent.
- E Drejta për të Harruar & për transferueshmërinë e të dhënave:** Individët mund të kërkojnë fshirjen dhe transferimin e të dhënave mes kontrolluesve.
- Kundërshtimi i Përpunimit:** Të drejtat të përmirësuara për të kufizuar përpunimin dhe për të paraqitur ankesa.

Detyrimet për Kontrollorët dhe Përpunuesit:

- Mbrojtja e të Dhënave në projektim dhe në mënyrë të paracaktuar:** Sigurimi i mbrojtjes së të dhënave gjatë gjithë fazave operacionale.
- Dokumentimi & Vlerësimi i Ndikimit:** Kontrolluesit duhet të mbajnë regjistra dhe të kryejnë vlerësime të ndikimit për proceset me rrezik të lartë.
- Njoftimi i Shkeljeve:** Kontrolluesit duhet të njoftojnë autoritetet për shkeljet e të dhënave brenda 72 orëve.
- Transferimet Ndërkombëtare të të Dhënave:** Transferimi i të dhënave personale drejt vendeve të huaja ose organizatave ndërkombëtare lejohet kur marrësi ndodhet në një shtet, territor ose bën pjesë në një ose më shumë sektorë të caktuar brenda shtetit të huaj ose në një organizatë ndërkombëtare, që siguron nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.

Sanctions

The law imposes significant financial penalties to enforce compliance, matching GDPR standards. Depending on the severity of the violation, fines can reach up to *1 billion ALL or or in the case of a commercial company, up to 2% of the total annual global turnover of the previous financial year, whichever is higher*, for breaching specific obligations of the law. For more severe violations, including failure to adhere to fundamental data processing principles, data subject rights, or international data transfer requirements, *finest can go up to 2 billion ALL or or in the case of a commercial company, up to 4% of the total annual global turnover of the previous financial year, whichever is higher*.

Implementation Timeline

- The law becomes enforceable 15 days post-publication in the Official Gazette, with some provisions pending the enactment of specific sub-legal acts within two years.
- With these rigorous measures, the new Albanian data protection law significantly boosts privacy rights and sets a formidable regulatory framework. Businesses are urged to audit their current practices, update policies, and ensure compliance to avoid substantial penalties.

Sanksionet

Ligji parashikon sanksione të konsiderueshme financiare për të forcuar përputhjen me standardet e GDPR. Sipas gradës së shkeljes, gjobat mund të arrijnë *deri në 1 miliard lekë ose, në rastin e një shoqërie tregtare, deri në 2% të xhiros globale vjetore totale të vitit financiar të mëparshëm, ciladoqoftë më e lartë, për shkeljen e detyrimeve specifike të ligjit*. Për shkelje më të rënda, duke përfshirë mosrespektimin e parimeve bazë të përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjektit të të dhënave ose kërkesat për transferime ndërkombëtare të të dhënave, gjobat mund të shkojnë *deri në 2 miliard lekë ose, në rastin e një shoqërie tregtare, deri në 4% të xhiros globale vjetore totale të vitit financiar të mëparshëm, ciladoqoftë më e lartë*.

Hyrja në fuqi

- Ligji bëhet hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare, me disa dispozita që presin miratimin e akteve nën-ligjore specifike brenda dy viteve.
- Me këto masa, ligji i ri shqiptar për mbrojtjen e të dhënave rrit ndjeshëm mbrojtjen e të dhënave personale dhe vendos një kuadër të fuqishëm rregullator. Bizneset këshillohen të kontrollojnë praktikatat e tyre aktuale, të përditësojnë politikatat dhe të sigurojnë përputhjen për të shmangur sanksionet e larta.



Legal Assistance from PwC Albania Legal Department

Our Legal Department is readily available to offer you personalized support and guidance on how this new law might impact your unique situation. We are equipped to assist with a range of services, including but not limited to:

- Compliance Assessment: Conduct a gap analysis to identify non-compliance areas and assess data protection risks.
- Strategic Advisory and implementation support: Align your data protection policies with the new law; develop a tailored compliance strategy; update privacy policies, offer trainings etc.
- Monitoring and Support: Provide ongoing compliance monitoring, updates on legal changes, and breach management services.
- Authority Liaison: Assisting with navigating procedures with the Commissioner. Facilitating communication with regulatory bodies through the submission of requests, documents, and notification forms.

Should you require further clarification or wish to discuss any matters in depth, please feel free to reach out. We are committed to providing you with the assistance you need to navigate the complexities of new legislation requirements with confidence.

Disclaimer

It is important to note that the content is for informational purposes only. It should not be considered legal advice or a replacement for personalized legal guidance. Readers are advised to consult professional legal counsel before taking any actions based on the information provided.

Asistenca Juridike nga Departamenti Ligjor i PwC Shqipëri


Departamenti ynë Ligjor është gjithmonë në dispozicion për t'ju ofruar mbështetje dhe udhëzime të personalizuar për ju mbi mënyrën se si ky ligj i ri mund të ndikojë në situatën tuaj unike. Ne jemi të pajisur për t'ju ndihmuar me një sërë shërbimesh, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- Vlerësimi i Përputhshmërisë: Kryerja e një analize të boshllëqeve dhe mangësive për të identifikuar zonat e mos-përputhjes dhe për të vlerësuar rreziqet në mbrojtjen e të dhënave personale.
- Këshillim Strategjik dhe Mbështetje për Zbatimin: Përshtatja e politikave tuaja të mbrojtjes së të dhënave personale me ligjin e ri; zhvillimi i një strategjie të dedikuar për përputhshmëri; përditësimi i politikave të privatësisë, ofrimi i trajnimeve, etj.
- Monitorim dhe Mbështetje: Sigurimi i monitorimit të vazhdueshëm të përputhshmërisë, përditësime mbi ndryshimet ligjore dhe shërbime të menaxhimit të shkëlqeve.
- Komunikime me Autoritetet: Asistencë në navigimin e procedurave me Komisionerin. Lehtësimi i komunikimit me organet rregullatore përmes paraqitjes së kërkesave, dokumenteve dhe formularëve të njoftimit.

Nëse keni nevojë për sqarime të mëtejshme ose dëshironi të diskutoni ndonjë çështje në thellësi, ju lutemi mos ngurroni të kontaktoni. Ne jemi të përkushtuar t'ju ofrojmë ndihmën që ju nevojitet për të kuptuar kompleksitetin e kërkesave të legjislativitetit të ri.

Përgjashtim nga përgjegjësia

Është e rëndësishme të theksohet se përmbajtja është vetëm për qëllime informative. Nuk duhet të konsiderohet këshilla ligjore ose një zëvendësim për udhëzimet ligjore të personalizuar. Lexuesit këshillohen që të konsultohen me një këshilltar ligjor profesionist përpara se të ndërmarrin ndonjë veprim bazuar në informacionin e dhënë.





Let's talk

PricewaterhouseCoopers Albania

Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1 Tirana, Albania

Telephone: +355 4 22 90 700

Email: al_pwc_albania@pwc.com

Web: www.pwc.com/al